
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 28.04.2025

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje materiale për lyerje”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 44810000 - 1: Bojra
44800000 - 8: Bojra, vernik dhe stuko;

Vlera e fondit limit: **3,942,616** (tre milion e nëntëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. OE duhet te paraqese vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 14001 “Mbi sistemin e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent, është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikate lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohet edhe ekuivalenti i tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

ISO 14001 “Mbi sistemin e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent, i kushton një rëndësi parësore mbrojtjes së mjedisit për vetë natyrën që mbartin këto produkte objekt prokurimi. Ky certifikim ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Certifikimi i operatorëve ekonomikë ofertues me Certifikatën ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit garanton autoritetin kontraktor për sigurinë e trajtimit të produkteve në të gjithë zinxhirin e furnizimit nga burimi i furnizimit deri në destinacionin e kërkuar

3. Ofertuesi, nëse nuk është prodhues, për mallrat objekt prokurimi që kanë me shume sasi, për artikujt me **Nr. 1, 3 dhe 5** sipas tabelës të paraqitur në Shtojcën Nr.7 të DST, duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi, ose distributori zyrtar i autorizuar, i cili merr përsipër të furnizojë ofertuesin me mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizim distributori, operatori

ekonomik ofertues duhet të paraqesë një letër angazhim ose akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit, e vlefshme midis tyre.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar, për artikujt me **Nr. 1, 2, 3, 4, 5,6,7,9 dhe 11** sipas tabelës të paraqitur në Shtojcën Nr.7 të DST. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse katalogu/ët që janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mallrat e ofruara nga operatori ekonomik.

5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1 (një)** automjet për transportin e mallrave objekt prokurimi, të cilin duhet ta ketë në pronësi, me qira ose në përdorim sipas rregullimeve ligjore. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë si :

- a. Akti që vërteton pronësinë ose Kontratë qeraje apo përdorimi (e vlefshme),
- b. Leje qarkullimi,
- c. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm),
- d. Sigurimin e detyrueshëm të mjetit (e vlefshëm).
- e. Fotografi të mjetit ku të evidentohet targa.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesit e kualifikuar si të sukseshëm, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetin e transportit, që ka në dispozicion apo

që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, me qëllim transportimin e mallit objekt prokurimi sipas specifikimeve teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

1. ASTAR PËR JASHTË

Izolues akrilik (polimer akriliku) për sipërfaqe të jashtme, i cili të hollohet me ujë dhe të jetë në gjendje për të konsoliduar lidhjen midis shtresave të ndryshme si gips, çimento, suva, beton etj. dhe shtresës së bojës. Të jetë i lehtë në aplikim dhe të ketë normë të lartë përhapje.

Karakteristikat Teknike:

Natyra e lidhësit:	Kopolimer (rezinë) akriliku
Tharja:	≤ 5 orë
Norma e hapjes:	$\geq 15 \text{ m}^2/\text{litër}$ me një shtresë
Pesha specifike:	$1.1 \pm 0.1 \text{ kg/litër}$
Pamja estetike:	Transparente ose me ngjyrë
Magazinimi:	Në temperatura në intervalin $+5^\circ\text{C}$ deri në $+30^\circ\text{C}$
Jetëgjatësia:	jo më pak 1 (një) vit nga lëvrimi
Hollimi me ujë:	$\geq 50\% - 100\%$
Paketimi:	Në kova plastike ose metalike 1-15 litra

2. ASTAR PER BRENDË

Izolues vinilik (PVA polimer) për sipërfaqe të brendshme, i cili të hollohet me ujë dhe të jetë në gjendje për të konsoliduar lidhjen midis shtresave të ndryshme si gips, çimento, suva, beton etj. dhe shtresës së bojës. Të jetë i lehtë në aplikim dhe të ketë normë të lartë përhapje.

Karakteristikat Teknike:

Natyra e lidhësit:	Kopolimer (rezinë) viniliku
Tharja:	≤ 5 orë
Norma e hapjes:	$\geq 15 \text{ m}^2/\text{litër}$ me një shtresë
Pesha specifike:	$1.1 \pm 0.1 \text{ kg/litër}$
Pamja estetike:	Transparente
Magazinimi:	Në temperatura në intervalin $+5^\circ\text{C}$ deri në $+30^\circ\text{C}$
Jetëgjatësia:	jo më pak 1 (një) vit nga lëvrimi
Hollimi me ujë:	$\geq 100\% - 300\%$
Paketimi:	Në kova plastike ose metalike 1-15 litra

3. BOJË HIDROPLASTIKE CILESI E PARE

Bojë plastike për lyerje të brendshme. Boja plastike të jetë cilësore, pa erë që nuk ndikon në përhapjen e zjarrit, të përdoret për ambiente të brendshme. Përbëja e saj duhet të jetë me bazë vinilike (PVA polimer) dhe në shpërndarje ujore i jep asaj rezistence optimale ndaj agjenteve të jashtëm. Formula e saj nuk duhet të dëmtojë përdoruesin dhe të jetë e përshtatshme për t'u aplikuar mbi suva, tullë, gips, beton etj. Duhet të ketë aftësi të mira mbuluese.

Karakteristikat teknike:

Natyra e lidhësit:	Kopolimer (PVA polimer) vinilike
Viskoziteti:	100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
Tharja për rilyerje:	≤ 5 orë
Norma e hapjes:	≥ 9 m ² /litër me dy shtresa
Pesha specifike:	1.5 ± 0.2 kg/litër
Hollimi:	10-15% me ujë
Pamja estetike:	E lëmuar, mat, pa shkëlqim
Ngjyrat në dispozicion:	E bardhë ose të ndryshme sipas katalogut
Magazinimi:	Në temperatura në intervalin + 5 °C deri në + 30 °C
Jetëgjatësia:	jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi
Paketimi:	Në kova plastike ose metalike 1-15 litra

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Përmbajtja e VOC (përbërësit organikë të paqëndrueshëm): ≤ 30 g/l.
- Rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e II-të.
- Fuqia mbuluese e bojës të jetë jo më pak se Klasa e II-të.

4. BOJË FASADE E BARDHË

Bojë për fasadë akrilike me ngjyrë të bardhë, për lyerje të jashtme. Boja për fasada duhet të jetë e prodhuar për përdorim të jashtëm me rezistencë ndaj agentëve atmosferikë. Boja do të ofrohet nga kontraktuesi sipas ngjyrave të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Të jetë e përshtatshme për sipërfaqe të re apo të vjetër si suva, e stukuar, e lyer etj. dhe të ketë shkallë të lartë mbulimi.

Karakteristikat Teknike:

Natyra e lidhësit:	Kopolimer (rezinë) akriliku
Viskoziteti:	100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
Tharja për rilyerje:	≤ 5 orë
Norma e hapjes:	≥ 9 m ² /litër me dy shtresa
Pesha specifike:	1.5 ± 0.2 kg/litër
Hollimi:	10-15 % me ujë
Pamja estetike:	E lëmuar, mat, pa shkëlqim
Ngjyrat që kërkohen:	E bardhë
Magazinimi:	Në temperatura në intervalin + 5 °C deri në + 30 °C
Jetëgjatësia:	jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi
Paketimi:	Në kova plastike ose metalike 1-15 litra

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Përmbajtja e VOC (përbërësit organikë të paqëndrueshëm): ≤ 40 g/l.
- Rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.

- Fuqia mbuluese e bojës të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.

5. BOJË FASADE ME NGJYRE

Bojë për fasadë akrilike me ngjyrë (ngjyra do të përcaktohet nga AK sipas nevojave), për lyerje të jashtme. Boja për fasada duhet të jetë e prodhuar për përdorim të jashtëm me rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë. Boja do të ofrohet nga kontraktuesi sipas ngjyrave të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Të jetë e përshtatshme për sipërfaqe të re apo të vjetër si suva, e stukuar, e lyer etj. dhe të ketë shkallë të lartë mbulimi.

Karakteristikat Teknike:

Natyra e lidhësit:	Kopolimer (rezinë) akriliku
Viskoziteti:	100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
Tharja për rilyerje:	≤ 5 orë
Norma e hapjes:	≥ 9 m ² /litër me dy shtresa
Pesha specifike:	1.5 ± 0.2 kg/litër
Hollimi:	10-15 % me ujë
Pamja estetike:	E lëmuar, mat, pa shkëlqim
Ngjyrat që kërkohen:	sipas katalogut RAL (RAL 4008, RAL 3000, RAL 5017, RAL 1003, RAL 6010, RAL 9017, RAL 1032).
Magazinimi:	Në temperatura në intervalin + 5 °C deri në + 30 °C
Jetëgjatësia:	jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi
Paketimi:	Në kova plastike ose metalike 1-15 litra

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Përmbajtja e VOC (përbërësit organikë të paqëndrueshëm): ≤ 40 g/l.
- Rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.
- Fuqia mbuluese e bojës të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.

6. BOJË BETONI (BOJE ÇIMENTATO)

Boja për sipërfaqe betoni e cila të përbëhet nga polimere akrilike me bazë uji dhe të shërbejë për përdorim të jashtëm, për sipërfaqe të strukturave të betonit. Ajo duhet të sigurojë lidhje të fortë me strukturën e betonit, papërshkueshmëri të ujit, qëndrueshmëri ndaj rrezeve ultraviolet dhe erozionit të agjentëve atmosferikë, papërshkueshmëri të gazit CO₂ dhe joneve të klorurit. Të ketë mbulim të mirë dhe aplikim të lehtë me rrul, furçë dhe pistoletë.

Karakteristikat teknike:

Natyra e lidhësit:	Kopolimer (rezinë) akrilike
Forca e ngjitjes:	≥ 2 N/mm ²

Tharja për rilyerje:	≤ 8 orë
Norma e hapjes:	≥ 5 m ² /litër me dy shtresa
Pesha specifike:	1.4 ± 0.2 kg/litër
Rezistenca ndaj gërvishtjeve:	≥ 2 N
Hollimi:	20-25% me ujë
Magazinimi:	Në temperatura në intervalin + 5 °C deri në +30 °C
Jetëgjatësia:	jo më pak 1 (një) vit nga lëvrimi
Paketimi:	Në kova plastike ose metalike 1-10 litra

7. BOJË PËR DRU

Boja të jetë me bazë rezine alkide, e cila i jep produktit mbulim të madh dhe rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë. Të jetë me shkëlqim dhe e përshtashme për të gjitha sipërfaqet drusore në ambiente të brendshme dhe të jashtme.

Karakteristikat teknike:

Natyra e lidhësit:	Rezinë Alkide
Viskoziteti:	80 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
Tharja për rilyerje:	≤ 8 orë
Norma e hapjes:	≥ 5 m ² /litër me dy shtresa
Hollimi:	5% -10% me solvent
Pesha specifike:	1.2 ± 0.2 kg/litër
Pamja estetike:	me shkëlqim
Ngjyrat në dispozicion:	E bardhë ose të ndryshme sipas katalogut
Magazinimi:	Në temperatura në intervalin + 5 °C deri në +30 °C
Paketimi:	Në paketim metalik 0.5-3 Litër

8. PLASTAMAS ME TOPA

Trashesia 0.5- 1mm, Transparent, topi jo më pak se 50m².

9. TRETËS(HOLLUES) PËR BOJË ZMALTO

Hollues për bojëra të shërbejë si pastrues për pajisjet e aplikimit. Të ketë shkallë të lartë e avullimi për të mundur përmirësimin e aplikimit.

10. KARTON PER MBULIM PARKETI

Jo me pak se 10 kg/top. Siperfaqe mbulimi jo me pak se 30 m².

11. BOJË BIKOMPONENTE

Boja të jetë me përbërje metil metakrilati (Methyl Methacrylate MMA), e cila shërben për përdorim të jashtëm, në sipërfaqe rrugësh, parkingje, sheshe sportive etj. Kjo lloj rezine është e përshtatshme posaçërisht për të realizuar një tharje sa më të shpejtë për shkak të natyrës së aplikimit. Të ketë mbulim të mirë dhe aplikim të lehtë me rrul, furçë dhe pistoletë.

Karakteristikat Teknike:

- Natyra e lidhësit bazë:	Rezinë metil metakrilati (Methyl Methacrylate MMA)
- Viskoziteti:	100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
- Tharja:	≤ 30 min në 25°C
- Norma e hapjes:	≤ 1.5 kg/m ² (spesor 1mm)
- Pesha specifike:	1.7 ± 0.2 kg/litër
- Ngjyrat në dispozicion:	Sipas kërkesave të AK
- Magazini:	Në temperatura në intervalin + 5 °C deri në +30 °C
- Jetëgjatësia:	jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi
- Paketimi:	Në kova plastike ose metalike 3-20 litra

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritura nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfituese, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Theksojme se edhe afati i levrimit është kërkuar nga Autoritetet Kontraktor përfituese.

NJËSIA E PROKURIMIT: